

# Preportr



2018

## UNIVERSITETI SI FUSHATË





## Universitetet publike në Kosovë përballen me vështirësi të mëdha në realizimin e punës së tyre. Meqë janë themeluar si premtim në fushatë zgjedhore, pa buxhet e kushte, këto universitete ndikohen lehtë nga politika e cila është munduar t'i arrijë synimet e saj duke ndërhyrë në mënyra të ndryshme në punën e tyre.

---

Besa Kalaja & Besnik Boletini

---

**A**snjëherë nuk është diskutuar hapur për nevojën e themelimit të universiteteve të tjera publike në Kosovë. Kjo “nevojë” ka lindur në kohë fushate zgjedhore, dhe këto institucione të arsimit të lartë në Kosovë janë në udhëkryq – mes nevojës së tyre për t'u konsoliduar dhe kërkesës së MASHT-it për t'u mbyllur.

Sado që hapja e gjithë këtyre universiteteve duket e paarsyeshme për një vend të vogël siç është Kosova, pas hapjes së tyre kanë ndodhur ndërhyrje të shumta – që nga punësimet e stafit me preferenca partiake, e deri te rasti i fundit kur Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), pa i vizituar dhe pa marrë qëndrimin e tyre ka dalë me një raport ku sugjerohet mbyllja e tyre.

Universitetet publike nuk kanë arritur ta krijojnë identitetin e tyre në atë masë sa të mos ndikohen lehtë, apo sa të mos lejojnë të jenë objekt trajtimi sa herë që ndërrohen qeveritë, pasi ministria udhëhiqet nga një subjekt tjetër politik.

Ekipi i Preportrit ka dalë në terren dhe e ka parë për së afërmi se si funksionojnë këto institucione të arsimit të lartë në vend. Gjendja nuk është e mirë as në aspektin e kushteve, të kadrove e të cilësisë, e në anën tjetër numri i studentëve është mjaft i lartë –afër 50 mijë studentë në të gjashtë universitetet.


Kjo ka ardhur për faktin se këto universitete nuk kanë buxhet të mjaftueshëm që të funksionojnë ashtu si duhet, nuk kanë staf të mjaftueshëm, dhe infrastruktura nuk është e përfunduar edhe pse në disa prej tyre janë ndërtuar objektet e reja, e disa kanë në plan të merren me një gjë të tillë në të ardhmen.

Universitetet publike përveç Universitetit të Prishtinës, funksionojnë si të pavarura mirëpo kanë një ndërvarësi me MASHT-in sepse ende funksionojnë si nënprograme buxhetore të ministrisë.

## SI N'PAZAR

Hapja e gjashtë universiteteve të tjera publike në Kosovë nuk është parë e nevojshme sidomos pasi që kjo ishte bërë pa një analizë paraprake dhe pa i parë nevojat në terren. Megjithatë Qeveria e Kosovës që në atë kohë udhëhiqej nga Hashim Thaçi mori vendim që në Kosovë të hapen edhe gjashtë universitete të reja publike. Premtimi për hapjen e tyre u bë në kohë fushate parazgjedhore.

Të gjitha këto komuna ku janë hapur universitetet në të kaluarën kishin shkolla të larta por edhe fakultete të cilat ishin pjesë e Universitetit të Prishtinës. Për to ekzistonte një bazë infrastrukturore, mirëpo sfidat në fillim ishin mjaft të mëdha edhe për faktin se aty ishin punësuar njerëz



pa përgatitje të mjaftueshme. Kjo kishte arritur deri në atë pikë sa mësim kanë dhënë edhe njerëz me nivelin e studimeve baçelor. Vetëm në Prizren shtatë profesorë ishin me baçelor, e disa të tjerw të diplomuar në kolegje private. Disa prej tyre notën mesatare e kishin pak më të lartë se gjashtë. Megjithatë duket se ky problem është zgjidhur në të gjitha këto universitete dhe ato janë duke punuar drejt konsolidimit të mëtejme. Disa prej tyre i kanë vënë detyrë vetes të profilizohen, kërkesë kjo edhe e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Rektorët e pesë universiteteve me të cilët ka folur ekipi i Preportrit, kanë thënë të kenë dëgjuar fjalë në media që ministria ka kërkuar që këto universitete të mbyllen ose të profilizohen. Mbyllja u duket absurde kur dihet që ende po investohet në ndërtimin e infrastrukturës dhe në rritjen e stafit. Megjithëse është diskutuar shumë për raportin e përfolur të MASHT-it, Preportr ka kërkuar qasje në këtë dokument. Ekipi nuk ka arritur ta sigurojë raportin, por në një përgjigje të dërguar përmes postës elektronike, zyrtarë të MASHT-it na kanë thënë se ai raport ekziston dhe për të po diskutohet në nivel të Qeverisë. Në ndërkohë, raporti ka qarkulluar nëpër media dhe në të përmendet mbyllja e universiteteve dhe shndërrimi i tyre në fakultete që funksionojnë në kuadër të Universitetit të Prishtinës. Në raport flitet për mungesën e cilësisë, për stafin e papërgatitur, për atë se si këto universitete e

**“As nuk kemi pas kontakt, nuk ka ardhë askush me bisedu me ne. Ata e kanë bërë një raport. Nuk kanë ardhur se po të kishin ardhë ne kemi qenë të gatshëm të takohemi me ta”.**

**BAJRAM KOSUMI**  
Rektor i Universitetit të Gjilanit

riprodhojnë njëri-tjetrin duke ofruar programe të njëjta, për mungesë të strategjive dhe planeve, etj.

Se çfarë është marrë për bazë në hartimin e këtij raporti ende nuk dihet, kur merret parasysh se sipas rektorëve të universiteteve publike, asnjë komision nuk ka shkuar t’i vizitohë dhe të marrë qëndrimin e tyre. Komisioni e ka vizituar vetëm Universitetin e Gjakovës. Sipas rektorit Shaban Buza, në këtë universitet komisioni është njoftuar për mbarëvajtjen e punës. Te universitetet e tjera ky qëndrim i ministrisë ka krijuar konfuzion.

“As nuk kemi pas kontakt, nuk ka ardhë askush me bisedu me ne. Ata e kanë bërë një raport. Nuk kanë ardhur se po të kishin ardhë ne kemi qenë të gatshëm të takohemi me ta”, thotë rektori i Universitetit të Gjilanit, Bajram Kosumi.

Kosumi ka thënë se vendimi i ministrisë për të krijuar komision i cili e bën vlerësimin e punës së universiteteve ka krijuar konfuzion te stafi dhe të studentët. Ai thotë se pasoja e parë është që ka pasur numër më të vogël të të interesuarve që këtë vit akademik të regjistroheshin në këtë universitet.

Qëndrim të njëjtë me Kosumin kanë ndarë edhe rektorët e tjerë të cilët janë habitur se si ka mundësi që të bëhet vlerësim pa u parë gjendja në universitete, kurse rektori i Universitetit të Mitrovicës, Alush Musaj, tha që nuk e ka idenë se dikush ka nxjerrë raport, apo se është bërë ndonjë vlerësim.

## NEVOJA PËR PROFILIZIM

Vlerësimi që thuhet se e ka bërë ministria ka ardhur në kohën kur universitetet po përballen me nevojën për të krijuar kushte më të mira për studentët. Disa prej tyre shpëtimin e shohin te profilizimi derisa të tjerët mendojnë se këtyre universiteteve u duhet më shumë buxhet për ta vazhduar punën dhe për të krijuar kushte më të mira. Universitetet që kanë pasur një bazë si ai i Mitrovicës – që është i orientuar më shumë në shkencat teknike – e kanë më të lehtë profilizimin.

Të profilizohen e kanë të lehtë dhe gati janë duke shkuar në atë drejtim, thonë rektorët e Universitetit të Pejës dhe të Gjakovës. Gjilani dhe Prizreni po kërkojnë të krijojnë veçantinë e tyre duke iu përshtatur nevojave dhe mundësive që i kanë këto komuna: Gjilani në matematikë, Prizreni në trashëgimi kulturore dhe turizëm. Mirëpo që të realizohet kjo duhen mjete materiale dhe resurse humane.

Rektori i Universitetit të Pejës, Fadil Millaku, thotë se ky universitet është gati i profilizuar.

“Ne këtu kemi Fakultetin e Agrobiznesit. Regjioni i Dukagjinit njihet për bujqësi dhe agrobiznes. Ne kemi drejtimet si teknologji e prodhimit bimor, agro mjedis, agroekologji dhe teknologji ushqimore. E kemi Fakultetin e Turizmit. Peja është vend turistik, i ka alpet shqiptare këtu. E kemi Fakultetin e Biznesit. Peja është vend i biznesit dhe ka nevojë për kuadro në fushën e biznesit. E kemi edhe Fakultetin Juridik dhe për fat të mirë, konkurrenca ka qenë më e madhe në këtë fakultet. E kemi edhe Fakultetin e Arteve”, thotë ai për të dëshmuar se rajoni i Pejës është i orientuar nga biznesi, prandaj universiteti mund të krijojë kuadro për nevoja të tregut.

Gjakova sipas rektorit Buza, profilizimin e ka pasur si parësore dhe është munduar që këtë çështje ta shtyjë përpara edhe në takimet me rektorët e tjerë, por edhe me Ministrinë e Arsimit.

Më të vështirë e sheh profilizimin rektori i Universitetit të Gjilanit, Bajram Kosumi. Ai thotë se profilizimi është futë si fjalë dhe tingëllon këndshëm por në fakt kjo fjalë po përdoret më shumë për t'i sulmuar universitetet e reja. Madje ai thotë se profilizimin nuk ka arritur ta bëjë as Universitetit i Prishtinës, ani pse si ide është diskutuar para pesë gjashtë vitesh.

Vlen të theksohet se të gjitha universitetet publike në programin e tyre e kanë futur juridikun dhe ekonominë por në disa prej tyre kritika më e madhe edhe prej

njohësve të fushës së arsimit ka qenë në këtë pikë. Ajo që është diskutuar shumë ka qenë fakti përse është dashur që të gjitha universitetet përveç Gjakovës t'i kenë këto drejtime në universitetet e tyre dhe kjo është bërë pa ndonjë analizë paraprake për të parë se cilat janë nevojat e tregut.

**Të profilizohen e kanë të lehtë dhe gati janë duke shkuar në atë drejtim, thonë rektorët e Universitetit të Pejës dhe të Gjakovës. Gjilani dhe Prizreni po kërkojnë të krijojnë veçantinë e tyre duke iu përshtatur nevojave dhe mundësive që i kanë këto komuna: Gjilani në matematikë, Prizreni në trashëgimi kulturore dhe turizëm. Mirëpo për të ndodhë kjo duhen mjete materiale dhe resurse humane.**





**Rektorët e pesë universiteteve me të cilët ka folur ekipi i Preportrit, kanë thënë të kenë dëgjuar fjalë në media që ministria ka kërkuar që këto universitete të mbyllen ose të profilizohen. Mbyllja u duket absurde kur dihet që ende po investohet në ndërtimin e infrastrukturës dhe në rritjen e stafit.**

## **MË SHUMË PROFESORË TË ANGAZHUAR SE TË RREGULLT**

Për profilizim duhet staf akademik i profilizuar. Universitetet publike duke përfshirë edhe atë të Prishtinës hallin më të madh e kanë te mungesa e stafit. Të gjitha këto universitete me pak përjashtime gjysmën e stafit e kanë staf të angazhuar. Kjo në një mënyrë e vështirëson punën pasi stafi i angazhuar nuk është tërë kohën në dispozicion të studentëve. Ata me kontratë e kanë për detyrë t'i mbajnë orët, provimet, etj.

Universitetet publike e kanë arritur një marrëveshje që stafi i tyre akademik një ditë në javë të japë mësim në një universitet tjetër publik përveç universitetit ku janë të angazhuar si staf i rregullt. Në këtë mënyrë ato i plotësojnë nevojat e njëri-tjetrit për staf.

Universiteti i Mitrovicës në këtë aspekt qëndron pak

më mirë. Në këtë universitet ka 110 profesorë të rregullt dhe rreth 35 profesorë të angazhuar. Tek të angazhuarit, ky universitet ka bashkëpunëtorë edhe nga Tirana.

Në Universitetin e Pejës më shumë ka profesorë të angazhuar – rreth 100, derisa staf i rregullt janë 74 profesorë dhe asistentë.

Prizreni në këtë aspekt i ka punët më keq sepse në semestrin e fundit ka pasur 66 profesorë dhe asistentë si staf i rregullt, ndërsa numri i të angazhuarve ka qenë dyfish më i madh, gjegjësisht 140. Rektori i këtij universiteti, Ramë Vataj, (në kohën kur Preportr e ka zhvilluar hulumtimin Ramë Vataj ka qenë ende rektor në këtë universitet), thotë se fakti që kanë më shumë bashkëpunëtorë të jashtëm sesa profesorë të rregullt sigurisht që i pengon shumë në punë. Prandaj thotë të ketë insistuar në vazhdimësi të marrin staf të rregullt.

Te Universiteti i Gjakovës raporti ndërmjet stafit të rregullt dhe atij të angazhuar është gati një me një. 45 profesorë dhe asistentë përbëjnë stafin e rregullt, derisa 50 prej tyre janë staf i angazhuar.

“Te stafi akademik qe tri vjet ka zhvillim shumë të mirë



**“Ka probleme, sepse mjetet nga projektet që ne jemi pjesë e tyre, së pari derdhën në buxhetin e qeverisë dhe mandej ato alokohen tek ne”**

**FADIL MILLAKU**  
rektor UP

në këtë drejtim. I kemi 30 doktorë shkence të pranuar në punë, por është e pamjaftueshme, 12 asistentë me ligj na kërkohet”, thotë rektori i Universitetit të Gjilanit, Bajram Kosumi.

Gjysma e orëve sipas tij mbahen nga bashkëpunëtorët e jashtëm dhe kjo paraqet vështirësi pasi ata nuk kanë obligim të rrijnë tetë orë në universitet.

“Interesi ynë do të ishte që 80 për qind stafi të jetë i rregullt e 20 të jashtëm. Tani është diku 60-40”, thotë ai.

## SFIDAT E PËRBASHKËTA

Universitetet publike kanë probleme me infrastrukturë. Në këtë aspekt më së miri qëndron Universiteti i Mitrovicës, Ky institucion para disa javësh është vendosur në objektet e reja të cilat janë mjaft moderne dhe investimi ka kushtuar rreth 15 milionë euro. Në hapësirën ku janë ndërtuar fakultetet dhe rektorati në të ardhmen parashikohet të ndërtohen edhe konviktet dhe mensa e studentëve.

Universitetet e tjera janë duke menduar të gjejnë hapësira të reja për ndërtim të kampuseve universitare pasi që në shumicën e rasteve mësimin e mbajnë në objekte të improvizuara që nuk i plotësojnë kushtet.

Sfidë e përbashkët e të gjitha këtyre institucioneve është mungesa e buxhetit.

Universitetet janë nënprogram i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe si të tilla buxhetin nuk e menaxhojnë vetë. Disa prej tyre thonë se e kanë mundësinë të kenë autonomi financiare ashtu siç e ka Universiteti i Prishtinës, pasi që kjo do t’i përcaktonte pastaj edhe nevojat dhe qëllimet e universiteteve.

Përveç kësaj, buxhetet e këtyre institucioneve janë shumë të ulëta – pak më shumë se 3 milionë euro për secilin.

“Sfidë është pavarësia financiare dhe buxheti i limituar. Ne nuk kemi mjete për të pagur stafin akademik për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare. Është shumë e nevojshme për asistentë dhe profesorë të marrin pjesë në konferenca të tilla”, thotë rektori i Universitetit të Gjilanit, Bajram Kosumi.



Një tjetër problem që e kanë universitetet është se ato nuk i menaxhojnë të hyrat vetanake. Edhe këto para derdhen në buxhetin e Qeverisë së Kosovës.

“Ka probleme, sepse mjetet nga projektet që ne jemi pjesë e tyre, së pari derdhen në buxhetin e qeverisë dhe mandej ato alokohen tek ne.....edhe menaxhimi i të hyrave do të kishte qenë më i lehtë dhe më i mirë në veçanti kur janë në pyetje bursat e studentëve”, thotë rektori i Pejës, Fadil Millaku.

Rektori i Universitetit të Mitrovicës Alush Musaj, kur flet për vështirësitë që i kanë me buxhet thotë se ky universitet mund të gjeneronte të hyra nga ekspertiza që mund t’u ofronin kompanive të mëdha.

“Mbi 70 për qind e profesorëve tonë punojnë në kompani të ndryshme private. Është interesant se këto kompani gjithmonë kërkojnë një leje të universitetit, një vulë, një marrëveshje me universitetin dhe ne nuk kemi të drejtë ta bëjmë një gjë të tillë, sepse ne nuk kemi të drejtë të krijojmë të hyra”, thotë ai.

Te Prizreni dhe Gjakova paraqiten të njëjtat probleme me buxhet.

“Ne i kemi rreth 400 mijë euro të hyra vetanake, asnjë cent nuk na vjen neve. Kemi projekte që kemi fituar dhe ato shkojnë në buxhet të Kosovës, ndërsa ne duhet t’i kërkojmë paratë tona. Do të thotë nuk kemi fare kod buxhetor dhe kjo është problem për të gjitha universitetet publike, përveç UP-së”, thotë rektori i Universitetit të Prizrenit, Ramë Vataj.



## PADI KUNDËR UNIVERSITETIT TË PEJËS

Në kohën sa Preportr ka qenë duke e realizuar hulumtimin për universitetet publike, në Gjykatën Themelore të Pejës ka filluar një proces gjyqësor kundër Universitetit të Pejës. Padinë kundër këtij universiteti e ka ngritur Bashkim Nurboja, kandidat për tri pozita të mësimdhënësit në Fakultetin e Biznesit, Fakultetin Juridik dhe Fakultetin e Menaxhimit në Turizëm Hoteleri dhe Mjedis në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, sipas konkursit për zgjedhjen e personelit akademik të rregullt, të shpallur më 9 maj 2018. Sipas padisë, Nurboja pretendon se gjatë procesit të rekrutimit atij i është bërë e padrejtë pasi kandidatët e tjerë ishin më pak të përgatitur.

“Padiësi është Doktor i Shkencave Ekonomike, i cili ka doktoruar në një nga universitetet më të mira botërore në lëminë e tij, ku kontributi i tij shkencor është mjaft serioz. I njëjti kontributi e tij akademik e ka materializuar në revista akademike kredibile ndërkombëtare, dhe asnjëherë nuk ka publikuar në revista shkencore të rreme”, thuhet në padi.

Rektori i Universitetit të Pejës, Fadil Millaku, nuk mendon që Nurbojes i është bërë e padrejtë. Ai thotë se ankesa e tij ka të bëjë me lëndët të cilat kanë dalë në konkurs për profesorët që janë staf i rregullt në UHZ dhe thirrja të cilën pretendon ta marrë kandidati është fituar nga kandidatët (profesorët) para katër viteve.

“Unë nuk njoh ndonjë rast që një profesor që ka marrë një thirrje në universitet është larguar nga puna dhe në vend të tij është zgjedhur dikush nga jashtë. Kjo do të paraqiste precedent. Përveç kësaj komisioni rrenczues ka vlerësuar se profesorët në fjalë i kanë plotësuar të gjitha kriteret sipas statutit të UHZ”, thotë ai.

## PROFESORË NGA PARTITË POLITIKE

Në universitetet publike një numër i madh i profesorëve janë të përkatësive të ndryshme partiake. Disa prej tyre kanë mbajtur pozitat më të rëndësishme publike në vend si atë të Kryeministrit dhe të deputetit. Katër nga gjashtë universitete udhëhiqen nga njerëz me përkatësi partiake – që të katër janë nga Partia Demokratike e Kosovës. Bajram Kosumi, rektor i Universitetit të Gjilanit, ka qenë Kryeministër i Kosovës në periudhën 2005-2006. Asokohe ai ka qenë pjesë e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, parti të cilën e ka lënë në vitin 2010 për t'ju bashkëngjitur PDK-së me “Listën Qytetare Për Demokraci”, me të cilën garoi për deputet në vitin 2010, post të cilin nuk arriti ta fitonte. Prej asaj kohe Kosumi nuk është parë të jetë angazhuar në politikë. Rektori i Universitetit të Prizrenit, Ramë Vataj, ka qenë deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së. Pjesë e PDK-së është edhe rektori i Ferizajt, Agron Bajraktari, i cili ka qenë këshilltar politik i Blerand Stavilecit, ish- Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (2008-2012), si dhe ai i Mitrovicës Alush Musaj. Musaj ka qenë sekretar i degës së PDK-së në Mitrovicë dhe drejtor i Inspeksionit

në Komunën e Mitrovicës në mandatin kur kryetar ishte Bajram Rexhepi.

Përveç rektorëve Preportr ka hulumtuar të gjitha pozitat e tjera udhëheqëse të universiteteve për të parë se sa prej tyre vijnë nga partitë politike. Janë shikuar pozitat e rektorëve, prorektorëve, këshillave drejtues të universiteteve, dekanëve, prodekanëve dhe të dhënat tregojnë se këto pozita mbahen prej një numri të madh të atyre të cilët kanë qenë apo janë ende pjesë e partive politike.

Të dhënat tregojnë se 35 persona prej këtyre që mbajnë këto pozita në 6 universitete dalin të jenë pjesë e partive politike. 15 janë të PDK-së, 6 të LDK-së, 3 të AAK-së, 5 të AKR-së, 2 të NISMA-s, 1 i Koalicionit Vakant, 1 i KDTP-së, 1 i Alternativës.

Disa prej tyre kanë ndërruar partinë më shumë se një herë.

Përveç që një pjesë e madhe e pozitave udhëheqëse janë me njerëz të partive politike, rektorët e këtyre universiteteve kanë garantuar që ndikimet politike, apo edhe ndikimet e grupeve të tjera të interesit në këto institucione janë të papërfillshme. Madje sipas tyre nuk ka pasur as tendenca të partive politike, qoftë të atyre në pushtet në nivel qendror apo atë lokal, që të ndërhyjnë në punësimet e stafit. Ata thonë se pozitat të cilat i kërkojnë janë të një natyre të veçantë dhe jo gjithkush mund t'i plotësojë kushtet për to.

## DISA PROGRAME NUK U AKREDITUAN

Sipas raporteve të Agjencisë Kombëtare të Akreditimit disa programe të universiteteve publike nuk u akredituan ndër vite. Preportr i ka shikuar raportet e viteve 2016-2017 dhe sipas tyre programet nuk iu akredituan këtyre universiteteve:

### UNIVERSITETI I FERIZAJT

2016

- Menaxhment dhe Teknologji, MSc, 120 ECTS, (me specializime: Dizajni i produkteve nga druri; Dizajni i produkteve nga plastika; Menaxhmenti industrial)

### UNIVERSITETI I GJAKOVËS

2016

- Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 240 ECTS

2017

- Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (0 – 3 vjeç), BA, 240 ECTS;
- Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, MSc, 120 ECTS.



## ZKA: PARREGULLSI NË UNIVERSITETE

Zyra Kombëtare e Auditimit në kuadër të raporteve për Ministrinë e Arsimit ka vlerësuar edhe punën e universiteteve publike. Në këto raporte vërehet se të gjitha universitetet i kanë pasur problemet e njëjta e të cilat në disa raste edhe janë adresuar. Problemet më të mëdha të tyre ishin vërejtur te pagat dhe mëditjet.

ZKA në vitin 2016 për universitetet publike kishte konstatuar se këto institucione të cilat funksionojnë në kuadër të MASH-T-it, nuk e plotësojnë pyetësorin e vetëvlerësimit, nuk kishin strategji zhvillimore (me përjashtim të Universitetit të Gjakovës), dhe nuk kishin plane vjetore të punës për vitin 2016 si dhe nuk kishin regjistër të rreziqeve.

Problem më i theksuar në raporte të auditorit ishte menaxhimi i pagave për profesorët. Gjatë auditimit të pagave të stafit akademik në gjashtë universitetet, ZKA-ja kishte hasur në shumë raste ku rregulloret për të ardhurat personale nuk janë zbatuar. Kjo sipas këtyre raporteve kishte rezultuar me pagesa edhe në rastet kur nuk është plotësuar norma, pagesa e avansit, etj.

Mirëpo në vitin 2017 u zbatua rekomandimi i ZKA-së që pagat dhe kompensimet të bëhen në pajtim me rregulloren për të ardhurat personale si dhe të forcohen kontrollet e vijueshmërisë.

Edhe në vitin 2017 disa universitete sipas ZKA-së kishin hartuar strategjitë e tyre, e disa jo. Në vitin 2017, Universiteti i Prizrenit, Universiteti i Gjilanit dhe Universiteti i Ferizajt nuk kishin hartuar plane strategjike.

Rektorët thonë se disa nga problemet që i kanë pasur në fillim tashmë i kanë eliminuar dhe kjo ka ndodhur sidomos te pagat dhe mëditjet.

Megjithëse auditori në njërin prej raporteve kishte konkluduar se qeverisja në të gjitha këto universitete kishte funksionuar mirë, si sfida për të gjitha universitetet sipas raportit mbeten ndërrimet e shpeshta të personave të ngarkuar me qeverisje dhe qëndrueshmëria e tyre.



### UNIVERSITETI I GJILANIT

2017

Nuk akreditohet programi i studimit i Universitetit të Gjilanit "Kadri Zeka":

- Edukimi Special, MSc, 120 ECTS.

### UNIVERSITETI I MITROVICËS

2017

Nuk riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini":

- Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS;
- Menaxhment dhe Informatikë, BA, 180 ECTS.

### UNIVERSITETI I PEJËS

2016

- Edukim Artistik në Pikturë, BA Profesional (240 ECTS);
- Edukim Artistik në Këndim, BA Profesional (240 ECTS).

Nuk riakreditohet programi i studimit:

- Menaxhim i burimeve njerëzore, MSc, 120 ECTS.

2017

II. Nuk riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka":

- Kushtetues Administrativ, LLM, 60 ECTS;
- Menaxhimi i Mjedisit, MSc, 120 ECTS.

# Lidhjet politike të stafit menaxhues të gjashtë universiteteve publike

Institucioni	Emri dhe mbiemri	Pershkrimi i pozites	Partia politike	Lidhja me partine
Universiteti i Prizrenit	Bedri Muhadri	Kryesues i Këshillit Drejtues të UPZ-së	NISMA	Ka aderuar në NISMA me 1 dhjetor 2017.
Universiteti i Prizrenit	Ragip Gjoshi	Anëtar i Këshillit Drejtues të UPZ-së	PDK	Ka qenë këshilltar politik i Ministrisë të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Ramë Buja. Ka marrë pjesë në fushatën e PDK-së dhe në Konventën e Fundit të PDK-së.
Universiteti i Prizrenit	Soner Yildirim	Anëtar i Këshillit Drejtues të UPZ-së	KDTP - Kosova Demokratik Türk Partisi	Ka qenë kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Prizrenit në zgjedhjet e vitit 2013
Universiteti i Prizrenit	Artan Nimani	Anëtar i Këshillit Drejtues të UPZ-së	PDK	Ka qenë anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës në vitin 2013. Ka qenë anëtar i Këshillit Drejtues të PDK-së
Universiteti i Prizrenit	Ramë Vataj	Retktor në UPZ	PDK	Është zgjedhur deputet në Kuvendin e Kosovës (12.12.2010 - 07.05.2014). Kandidat për deputet në zgjedhjet e vitit 2014. Kandidat për kryetar të Suharekës në vitin 2013.
Universiteti i Prizrenit	Kadri Kryeziu	Prorektor për Buxhet, Financa dhe infrastrukturë në UPZ	AAK	Ka qenë kandidat për deputet nga radhët e AAK-së në vitin 2004 dhe 2007. Ka qenë anëtar i Kryesisë së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2000-2009). Ka qenë zëvendësministër në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për një mandat të plotë qeveritar (dhjetor 2004 - janar 2008).
Universiteti i Prizrenit	Sadik Idrizi	Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë në UPZ	VAKAT	Ka qenë deputet i Kuvendit të Kosovës në dy mandate (17.11.2001 - 23.11.2004) dhe 13.12.2007 - 03.11.2010). Ka qenë Ministër i Shëndetësisë
Universiteti i Prizrenit	Flamur Shala	U.d Dekan në Fakultetin e Filologjisë në UPZ	LDK	Ka qenë anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës nga LDK (2009-2013, 2013-2017)
Universiteti i Prizrenit	Ismet Temaj	Dekan në Fakultetin e Edukimit	LDK	Në një reagim të menaxhmentit të UPZ-së thuhet se Ismet Temaj është anëtar i Kryesisë së Degës së LDK-së në Prizren
Universiteti i Gjakovës	Mimoza Kusari-Lila	Anëtare e Këshillit Drejtues në Universitetin e Gjakovës	Alternativa - AKR	Kryetare e Gjakovës e zgjedhur nga radhët e AAK-së. Aktualisht deputete në Kuvendin e Kosovës nga "Alternativa".
Universiteti i Gjakovës	Besim Muhadri	Anëtare e Këshillit Drejtues në Universitetin e Gjakovës	AAK-PDK	Ka qenë kandidat për deputet nga radhët e PDK-së në zgjedhjet nacionale të vitit 2001. Ka qenë kandidat për deputet nga radhët e AAK-së në zgjedhjet nacionale të vitit 2004.
Universiteti i Gjakovës	Januz Bunjaku	Prorektor për Buxhet dhe Financa	AKR	Ka qenë kandidat për Këshilltar Komunal në Komunën e Gjakovës
Universiteti i Gjakovës	Ilir Kelmendi	Dekan në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Gjakovës	AAK	Ka qenë drejtor i Drejtorisë për Arsimit në Komunën e Pejës (2008-2011). Është zgjedhur anëtar i Kuvendit Komunal në zgjedhjet lokale të vitit 2007. Ka qenë kandidat për deputet nga radhët e AAK-së në zgjedhjet e vitit 2004.
Universiteti i Gjakovës	Kamber Kamberi	Dekan në Fakultetin e Filologjisë	LDK	Ka qenë deputet në Kuvendin e Kosovës nga radhët e LDK-së.
Universiteti i Pejës	Muhamet Sadiku	Anëtar i këshillit drejtues në Universitetin Publik të Pejës	AKR	Ka qenë kandidat për deputet në listën e AKR-së nga grupi E-15 në zgjedhjet e vitit 2010. Ka qenë këshilltar i zëvendëskryeministrit të Kosovës Behgjet Pacolli.
Universiteti i Pejës	Nexhdet Shala	Dekan në Fakultetin e Agro Biznesit në Universitetin e Pejës	PDK	Ka qenë kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, në zgjedhjet lokale të vitit 2009
Universiteti i Pejës	Astrit Ademaj	Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin Publik të Pejës	PDK	Është zgjedhur anëtar i Kuvendit Komunal të Pejës në zgjedhjet lokale të vitit 2017

Universiteti i Pejës	Sabiha Shala	Prorektor për Mësimdhënie dhe Çështje Studentore	PDK	Ka qenë kandidatë e PDK-së për kryetare të Komunës së Pejës në zgjedhjet lokale të vitit 2017. Ka qenë kandidatë për deputete nga radhët e PDK-së në vitin 2007 dhe anëtare e kryesisë së forumit të gruas në degën e PDK-së në Pejë.
Universiteti i Pejës	Afrim Selimaj	Prorektor në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë	PDK	Ka qenë kandidat për Këshilltar Komunal në zgjedhjet lokale të vitit 2009. Me 2015 është zgjedhur anëtar i kryesisë së AAK-së, dega në Pejë. Në zgjedhjet nacionale të vitit 2017 ka marrë pjesë në aktivitetet elektorale të AAK-së
Universiteti i Pejës	Ibish Mazreku	Prorektor në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë	LDK	Në dhjetor të vitit 2015 është zgjedhur delegat për Kuvendin e Përgjithshëm të LDK-së në Rahovec. Ka marrë pjesë në fushata të ndryshme zgjedhore të LDK-së.
Universiteti i Mitrovicës	Adem Nura	Zëvendëskryesues Këshillit Drejtues të Universitetit të Mitrovicës	PDK	Ka qenë asamblist nga radhët e PDK-së në Komunën e Mitrovicës në vitin 2006. Ka qenë kandidat për asamble komunale në vitin 2009.
Universiteti i Mitrovicës	Ali Topalli	Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Mitrovicës	PDK	Anëtar i Kuvendit Komunal të Mitrovicës (2006). Kandidat për anëtar i Kuvendit Komunal të Mitrovicës në zgjedhjet e vitit 2007 dhe në zgjedhjet e vitit 2009.
Universiteti i Mitrovicës	Avdi Salihu	Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Mitrovicës	PDK	Anëtar i kryesisë të degës së PDK-së në Mitrovicë
Universiteti i Mitrovicës	Alush Musaj	Rektor i Universitetit të Mitrovicës	PDK	Ka qenë sekretari degës së PDK-së në Mitrovicë. Ka qenë drejtor i inspeksionit në mandatin e Bajram Rexhepit si kryetar i Komunës së Mitrovicës.
Universiteti i Mitrovicës	Mensur Kelmendi	Prodekani i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore në Universitetin e Mitrovicës	LDK	Ka qenë asamblist nga radhët e LDK-së në periudhën 2007-2009.
Universiteti i Mitrovicës	Hakif Zeqiri	Dekani i Fakultetit të Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Komputerike	PDK	Kandidat për këshilltar komunal në Komunën e Mitrovicës në vitin 2007
Universiteti i Ferizajt	Driton Sylejmani	Kryetari i Këshillit Drejtues në Universitetin e Ferizajt	AKR	Ka qenë kandidat për anëtar në Kuvendin Komunal të Ferizajt në zgjedhjet lokale të vitit 2007.
Universiteti i Ferizajt	Xhemajl Fejzullahu	Anëtar i Këshillit Drejtues në Universitetin e Ferizajt	LDK	Ka qenë kandidat për kryetar të Komunës së Ferizajt nga LDK. Ka qenë kryetar i degës së LDK-së në Ferizaj.
Universiteti i Ferizajt	Agron Bajraktari	Rektor në Universitetin e Ferizajt	PDK	Ka qenë këshilltar politik i Ministrisë të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Blerand Stavileci (2008-2012)
Universiteti i Ferizajt	Bujar Pira	Prorektor për marrëdhënie ndërkombëtare dhe sigurim të cilësisë në Universitetin e Ferizajt	AKR	Kandidat për deputet me "Koalicionin për Kosovë të Re" nga grupi E-15
Universiteti i Ferizajt	Afrim Loku	Prodekan për buxhet, financa, asetë dhe infrastrukturë	AKR	Kryetar i degës së AKR-së në Kaçanik (2013). Këshilltar komunal në vitin 2007 nga radhët e AKR-së në Kaçanik. Ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2009
Universiteti i Gjilanit	Merxhan Avdyli	Anëtar i këshillit drejtues në Universitetin e Gjilanit	AAK	Ka qenë këshilltar politik në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2002-2004). Ka qenë zëvendësministër në këtë ministri (2004-2008). Ka qenë kandidat për deputet nga radhët e AAK-së në vitin 2007.
Universiteti i Gjilanit	Nehat Rudhani	Anëtar i këshillit drejtues në Universitetin e Gjilanit	PDK/NISMA	Ka qenë kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Kamenicës në zgjedhjet lokale të vitit 2007. Delegat në konventën e VII të PDK-së, me 1 dhjetor 2017 i është bashkuar NISMES.
Universiteti i Gjilanit	Bajram Kosumi	Rektor në Universitetin e Gjilanit	PDK	Ka qenë kandidat për deputet në listën e PDK-së në zgjedhjet e vitit 2010. Ka qenë deputet nga radhët e AAK-së (13.12.2007 - 03.11.2010).
Universiteti i Gjilanit	Sadik Haxhiu	Dekani i Fakultetit Juridik	PDK	Ka qenë kandidat për deputet nga radhët e PDK-së në zgjedhjet e vitit 2014. Kryetar i degës së PDK-së në viti. Prej 17 korrikut 1999 deri me 31 janar 2000 ishte zëvendësministër i Ministrisë së Drejtësisë në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës.

# Preportr

BULETINI

Preportr – Qendra Kosovare për Gazetari Hulmuese është një projekt i filluar nga Organizata anti-korrupsion në Kosovë – ÇOHU. Projekti ka për qëllim ngritjen dhe mbështetjen e gazetarisë hulmuese në Kosovë përmes ofrimit të një hapësire alternative për gazetarët entuziastë që të transmetojnë hulumtimet e tyre pa frikën e censurës.

## BULETINI REDAKTOHET NGA:

Arton Demhasaj

## AUTORËT:

Besa Kalaja, Besnik Boletini

## DESIGN AND LAYOUT:

envinion

## TELEFONI:

038 248 506

## E-MAIL:

office@preportr.com.  
preportr.cohu.org

**Shënim:** Organizata Çohu është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS

Ky hulumtim është pjesë e programit të KITU-së. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të Organizatës Çohu! dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS.



Organizata për  
Demokraci, Antikorrupsion  
dhe Dinjitet, Çohu!



KOALICIONI PËR INTEGRITET DHE  
TRANSPARENCE NË UNIVERSITET



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society